

LIGJI Nr. 06/L -015

**MBI MASAT DOGANORE PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË PRONËSISË
INTELEKTUALE**

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton:

**LIGJ MBI MASAT DOGANORE PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË PRONËSISË
INTELEKTUALE**

Neni 1

Qëllimi

1. Ky ligj rregullon të drejtat, përgjegjësitë, parimet dhe masat doganore për veprim nga Dogana e Kosovës për mallrat të cilat janë të dyshimta për shkelje të të drejtave të pronësisë intelektuale.
2. Ky ligj përaftron Rregulloren (BE) Nr. 608/2013 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, e datës 12 Qershor 2013, lidhur me masat doganore për të drejtat e pronësisë intelektuale.

Neni 2

Fushëveprimi

1. Dispozitat e këtij Ligji zbatohen ndaj mallrave të dyshuara për shkelje të së drejtë së pronësisë intelektuale, mallrave të cilat duhet t'i nënshtrohen mbikëqyrjes apo kontrollit doganor, e në veçanti ndaj mallrave në rrethanat si në vijim:

- 1.1. kur mallrat deklarohen për lirim në qarkullim të lirë, eksport apo ri-import;
- 1.2. kur mallrat hyjnë apo dalin nga territori doganor i Republikës së Kosovës; dhe
- 1.3. kur mallrat janë të vendosura nën procedurën e transitit, procedurat e magazinimit doganor, procedurat e përpunimit të brendshëm, përpunimit nën mbikëqyrjen doganore, importit të përkohshëm, të vendosur në zonë të lirë, në depo të lirë doganore në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

2. Dispozitat e këtij ligji nuk zbatohen për:

- 2.1. mallrat të cilat janë liruar në qarkullim të lirë nën regjimin e përdorimit të veçantë përfundimtar;
- 2.2. mallrat e natyrës jo-komerciale që gjenden në bagazhin personal të udhëtarëve; dhe

2.3. mallrat të cilat janë prodhuar nga një person me pëlqimin e bartësit të së drejtës apo për mallra, të cilat janë prodhuar nga një person i autorizuar ligjërisht nga bartësit i së drejtës për prodhimin e një sasive të caktuar të mallrave, në tejkallim të sasive për të cilat është rënë dakord ndërmjet personit dhe bartësit të së drejtës.

3. Ky ligj nuk duhet të ndikoj në ligjet kombëtare mbi pronësinë intelektuale në lidhje me procedurat penale.

Neni 3 **Përkufizimet**

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këto kuptime:

1.1. **Person** – nënkupton personin fizik, personin juridik dhe personat e tjerë;

1.2. **Person fizik** - nënkupton çdo person që është shtetas i Republikës së Kosovës, shtetas i një shteti të huaj ose personi pa shtetësi;

1.3. **Person juridik** - nënkupton një entitet publik ose privat, shoqatë, shoqëri ose organizatë tjetër biznesi që ka statusin e një personi juridik sipas legjislacionit në fuqi mbi shoqëritë tregtare dhe çdo legjislacion tjetër të aplikueshëm në Republikën e Kosovës apo të një shteti tjetër.

1.4. **Personat e tjerë** – nënkupton shoqëritë tregtare të themeluara sipas legjislacionit në fuqi në Kosovë apo të një shteti të huaj, që nuk e kanë statusin e personit juridik;

1.5. **E drejta e pronësisë intelektuale** - nënkupton:

1.5.1. markën tregtare;

1.5.2. dizajnin industrial;

1.5.3. të drejtën e autorit apo ndonjë e drejtë e përafërt;

1.5.4. treguesin gjeografik;

1.5.5. emërtimin e origjinës;

1.5.6. patentën;

1.5.7. certifikatën për mbrojtje shtesë për produktet mjekësore sipas legjislacionit në fuqi;

1.5.8. certifikatën për mbrojtje shtesë për produktet e mbrojtjes së bimëve sipas legjislacionit në fuqi;

1.5.9. të drejtën e varietetit bimor;

1.5.10. topografinë e prodhimit gjysmë-përçues;

1.5.11. modelin e përdorimit për aq sa është e mbrojtur si një e drejte e pronësisë intelektuale në legjislacionin në fuqi; dhe

1.5.12. emrin tregtar për aq sa është i mbrojtur si një e drejtë ekskluzive e pronësisë intelektuale në legjislacionin në fuqi.

1.6. **Markë tregtare** - nënkupton markën tregtare të regjistruar në Republikën e Kosovës ose markën tregtare të regjistruar sipas marrëveshjeve ndërkombëtare në të cilat Republika e Kosovës është palë;

1.7. **Dizajn industrial** - nënkupton dizajnin industrial të regjistruar në Republikën e Kosovës ose dizajnin industrial të regjistruar sipas marrëveshjeve ndërkombëtare në të cilat Republika Kosovës është palë;

1.8. **Tregues gjeografik** – nënkupton treguesin gjeografik të mbrojtur sipas legjislacionit në fuqi, treguesin gjeografik për verërat, për pijet e aromatizuara të bazuara në produktet e verës, për pijet alkoolike dhe treguesin gjeografik sipas përcaktimeve në marrëveshjet ndërmjet Republikës së Kosovës dhe shteteve të tjera;

1.9. **Mallrat e falsifikuara**- nënkupton:

1.9.1. mallrat të cilat janë objekt i një veprimi që shkelin një markë tregtare të regjistruar në Republikën e Kosovës dhe bartin pa autorizim shenjë e cila është identike me markën tregtare që është e regjistruar në mënyrë të vlefshme në lidhje me llojin e njëjtë të mallrave, apo bartin shenjë e cila nuk mund të dallohet në aspektin thelbësor me markën tregtare të regjistruar;

1.9.2. mallrat të cilat janë objekt i një veprimi që shkelin një tregues gjeografik dhe bartin apo përshkruhen nga një emër apo shprehje e mbrojtur në lidhje me atë tregues gjeografik; dhe

1.9.3. çdo paketim, etiketë, afishe, broshurë, udhëzues përdorimi, dokument garantues apo ndonjë gjë tjetër e ngjashme, edhe nëse prezantohen ndarazi, që shkelin një markë tregtare apo tregues gjeografik, që përfshijnë një shenjë, emër apo shprehje e cila është identike me një markë të regjistruar në mënyrë të vlefshme apo ndonjë tregues të mbrojtur gjeografik, apo e cila nuk mund të dallohet në aspektet thelbësore nga njëmarkë tregtare apo tregues gjeografik dhe që mund të përdoret për llojin e njëjtë të mallrave, njëjtë sikur që është regjistruar marka tregtare apo treguesi gjeografik.

1.10. **Mallrat pirate** - nënkupton mallrat të cilat janë objekt i një veprimi që shkelin një të drejtë të autorit apo ndonjë të drejtë të përafërt apo të një dizajni industrial dhe të cilat janë, apo përmbajnë kopje të bërë pa pëlqimin e bartësit të së drejtës së autorit, të drejtës së përafërt apo të dizajnit industrial, apo të një personi të autorizuar nga bartësi i së drejtës në vendin e prodhimit;

1.11. **Mallra që dyshohet se shkelin një të drejtë të pronësisë intelektuale** - nënkupton mallrat e identifikuar në Republikën e Kosovës të cilat në pamje të parë kanë tregues të arsyeshëm se:

1.11.1. janë objekt i një veprimi që shkel një të drejtë të pronësisë intelektuale në Republikën e Kosovës;

1.11.2. janë pajisje, produkte apo komponentë që janë projektuar, prodhuar apo përshtatur kryesisht me qëllim për të mundësuar apo lehtësuar shmangien nga çdo teknologji, pajisje apo komponent, që në rrjedhën normale të operacionit të tij parandalon apo kufizon veprime lidhur me vepra të paautorizuara nga bartësi i të drejtave të autorit dhe çdo të drejtë tjetër lidhur me të dhe e cila lidhet me një veprim që shkel këto të drejta në Republikën e Kosovës; apo

1.11.3. kanë çdo format apo matricë të dizajnuar apo të përshtatur specifikisht për prodhimin e mallrave që shkelin një të drejtë të pronësisë intelektuale, nëse këto formate apo matrica lidhen me një veprim që shkel të drejtën e pronësisë intelektuale.

1.12. **Bartës i së drejtës** - nënkupton bartësin e një të drejte të pronësisë intelektuale;

1.13. **Aplikim** - nënkupton kërkesën që paraqitet pranë Doganës së Kosovës për të ndërmarrë veprime në lidhje me mallrat që dyshohet se shkelin të drejtën e pronësisë intelektuale;

1.14. **Aplikues**-nënkupton një person, sipas përcaktimit të nënparagrafëve 1.1, 1.2, 1.3 apo 1.4 të këtij neni në emër të të cilit është paraqitur aplikacioni;

1.15. **Bartës i vendimit** - nënkupton një person ndaj të cilit është dhënë vendimi në bazë të aplikimit;

1.16. **Bartësi i mallrave** - nënkupton personin që ka në pronësi mallrat që dyshohet se shkelin një të drejtë të pronësisë intelektuale apo që ka të drejta të ngjashme për tjetërsimin/shkatërrimin ose kontrollin fizik të këtyre mallrave;

1.17. **Deklaruesi** - nënkupton deklaruesin siç është përcaktuar në legjislacionin e zbatueshëm doganor;

1.18. **Shkatërrim** - nënkupton shkatërrimin fizik, riciklimin apo vendosjen e mallrave të tilla jashtë kanaleve komerciale, në atë mënyre që do të parandalonte dëmtimin ndaj bartësit të vendimit;

1.19. **Lirimi i mallrave** - nënkupton lëshimin e mallrave siç është përcaktuar në legjislacionin e zbatueshëm doganor;

1.20. **Ngarkesë e vogël** - nënkupton një ngarkesë postare apo postë e shpejtë, e cila:

1.20.1. përmban tri apo më pak njësi; ose

1.20.2. ka një peshë bruto më pak se dy (2) kilogramë.

1.21. **Njësi** - nënkupton mallrat e paketuara apo të pa paketuara, të klasifikuara sipas Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave në fuqi, qëllimi i të cilave është shitja

me pakice tek konsumatori i fundit. Për qëllime të këtij përkufizimi, mallrat e ndara që përfshihen në kodin e njëjtë të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave do të konsiderohen si njësi të ndryshme dhe mallrat e paraqitura si grupe i klasifikuar në një kod të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave do të konsiderohen si një njësi;

1.22. Mallrat që prishen lehtë - nënkupton ato mallra të cilat vlerësohen nga Dogana e Kosovës se mund të prishen nëse mbahen deri në njëzetë(20) ditë nga data e pezullimit të lirit apo ndaljes së tyre; dhe

1.23. Licencë ekskluzive - nënkupton licencën, qoftë të përgjithshme apo të kufizuar, që autorizon të licencuarin për të shfrytëzuar të drejtën e pronësisë intelektuale në atë mënyrë siç është autorizuar nga licenca duke përjashtuar të gjithë personat, përfshirë edhe personin që e jep licencën.

KAPITULLI II APLIKIMI PËR VEPRIM DOGANOR

Neni 4 E drejta për të dorëzuar aplikacionin

1. Të drejtën e dorëzimit të aplikacionit pranë Doganës së Kosovës, për të përcaktuar nëse një e drejtë e pronësisë intelektuale është shkelur, e kanë personat apo subjektet në vijim:

1.1. bartësit e së drejtës;

1.2. organet që administrojnë të drejtat kolektive të pronësisë intelektuale, që përcaktohen me legjislacionin në fuqi për të drejtat e autorit apo të drejtat e përfaqërta;

1.3. grupet e prodhuesve që administrojnë treguesit gjeografik, të cilët përfaqësojnë prodhuesit e produkteve me tregues gjeografik apo emërtim të origjinës; përfaqësuesit e grupeve të këtyre grupeve dhe entitetet afariste që kanë të drejtë të përdorin një tregues gjeografik; apo autoritetet përgjegjëse për tregues të tillë gjeografik sipas legjislacionit në fuqi.

1.4. personat të autorizuar për të përdorur të drejtat e pronësisë intelektuale, të cilët janë autorizuar zyrtarisht nga bartësi i të drejtave për të filluar procedurën, me qëllim që të përcaktojnë nëse është shkelur një e drejtë e pronësisë intelektuale.

Neni 5 Dorëzimi i aplikacioneve

1. Aplikacionet dorëzohen në Doganën e Kosovës, duke përdorur formularin specifik i cili përmban informacionin e përcaktuar në nenin 6 të këtij Ligji.

2. Kur aplikacioni paraqitet pas njoftimit nga Dogana e Kosovës për pezullimin e lirit apo ndalimin e mallrave, në përputhje me paragrafin 3 të nenit 18 të këtij Ligji, aplikacioni:

2.1. duhet të paraqitet pranë Doganës së Kosovës brenda katër (4) ditëve pune nga

data e njoftimit për pezullimin e lirit apo ndalimin e mallrave;

2.2. duhet të jetë sipas formës dhe të përmbajë informata të përcaktuara në nenin 6 të këtij Ligji;

2.3. Përgjithësisht nga nënparagrafi 2.1. i këtij neni, aplikacioni mund të mos përfshijë informatat e parapara në nënparagrafët 1.6., 1.7. dhe 1.8., të nenit 6 të këtij ligji;

2.4. duhet të paraqitet duke përdorur teknikat elektronike të përpunimit të të dhënave, kur kjo është e mundur.

Neni 6 **Forma e aplikacionit**

1. Aplikacioni përmban informacionet si në vijim:

1.1. detajet në lidhje me aplikuesin;

1.2. statusin e aplikuesit sipas nenit 4 të këtij ligji;

1.3. dokumentet që vërtetojnë se aplikuesi ka të drejtën e paraqitjes së aplikimit;

1.4. detajet e personit që përfaqëson dhe dëshminë se personi ka kompetencë të veprorë në cilësinë e përfaqësuesit në përputhje me legjislacionin në fuqi, kur aplikuesi e dorëzon aplikacionin përmes përfaqësuesit;

1.5. të drejtën apo të drejtat e pronësisë intelektuale që zbatohen;

1.6. të dhëna specifike dhe teknike për mallrat origjinale, përfshirë shenjat si shiriti kodifikues (barkode) dhe fotografitë, sipas nevojës;

1.7. informatat që i nevojiten Doganës së Kosovës që të identifikojë sa më shpejtë këto mallra;

1.8. informatat që i nevojiten Doganës së Kosovës për analizën dhe vlerësimin e riskut të shkeljes së të drejtës apo të të drejtave të pronësisë intelektuale, siç janë informatat për distributorët e autorizuar;

1.9. detajet e çdo përfaqësuesi të caktuar nga aplikuesi për të marrë përgjegjësi për çështjet ligjore dhe teknike;

1.10. shënimi për konfidencialitetin e informatave, nëse ofrohen informatat e parapara në nënparagrafët 1.6, 1.7 dhe 1.8 të këtij neni;

1.11. deklaratën e aplikuesit që njofton Doganën e Kosovës për çdo situatë të cekur në nenin 15 të këtij ligji;

1.12. deklaratën nga aplikuesi për të përcjell apo rifreskuar çfarëdo informate relevante

për analizë dhe vlerësimin e riskut të shkeljes së të drejtave të pronësisë intelektuale;

1.13. deklaratën e aplikuesit për të marrë përgjegjësinë sipas kushteve të përcaktuara në nenin 28 të këtij ligji;

1.14. deklaratën e aplikuesit për të bartur shpenzimet që parashihen në nenin 29 të këtij Ligji sipas kushteve të përcaktuara në atë nen;

1.15. marrëveshjen e aplikuesit sipas të cilës të dhënat e ofruara nga ai mund të përpunohen nga Dogana e Kosovës; dhe

1.16. nëse aplikuesi kërkon të përdor procedurën sipas nenit 26 të këtij ligji dhe, kur kërkohet nga Dogana e Kosovës, pajtohetë marr përsipër shpenzimet që ndërlihen me shkatërrimin e mallrave sipas kësaj procedure.

2. Dogana e Kosovës përcakton formularin e aplikimit me akt nënligjor.

Neni 7

Aplikacionet e pakompletuara

1. Në rast se Dogana e Kosovës konsideron se aplikacioni nuk përmban të gjitha informatat e kërkuara sipas nenit 6 të këtij ligji, kërkon nga aplikuesi që brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas pranimit të njoftimit të sigurojë informatat të cilat mungojnë. Në rastet e tilla, afati përfundimtar i paraparë në paragrafin 1 të nenit 9 të këtij ligji, pezullohet derisa të pranohen informatat e nevojshme.

2. Në rast se aplikuesi nuk i siguron informatat që mungojnë brenda afatit të përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni, Dogana e Kosovës refuzon aplikimin.

Neni 8

Lirimi nga pagesa

Aplikuesi nuk ngarkohet me pagesë për të mbuluar shpenzimet administrative që dalin nga përpunimi i aplikimit.

Neni 9

Njoftimi lidhur me vendimin

1. Dogana e Kosovës njofton aplikuesin mbi vendimin për aprovimin apo refuzimin e aplikimit brenda tridhjetë (30) ditëve pune nga pranimi i aplikacionit. Me rastin e refuzimit, Dogana e Kosovës njofton aplikuesin për arsyet e refuzimit dhe informon atë mbi procedurën e ankesës.

2. Nëse aplikuesi është njoftuar për pezullimin e liritimit apo ndalimin e mallrave nga Dogana e Kosovës përpara paraqitjes së aplikimit, Dogana e Kosovës njofton aplikuesin për vendimin për aprovim apo refuzim të aplikimit, brenda dy (2) ditëve të punës nga data e marrjes së aplikimit.

Neni 10

Vendimi për aplikacionin

1. Vendimi për aprovimin e aplikimit dhe çdo vendim për revokim apo përmirësim të këtij vendimi, hyn në fuqi një (1) ditë pas aprovimit.
2. Vendimi për zgjatjen e afatit gjatë së cilës Dogana e Kosovës duhet të veprojë, hyn në fuqi në ditën pasi të skadojë afati që duhet zgjatur.

Neni 11

Afati për veprim doganor

1. Kur aprovohet një aplikim, Dogana e Kosovës përcakton afatin gjatë së cilës duhet të veprojë. Ky afat fillon ditën kur merret vendimi për aprovimin e aplikimit, sipas nenit 9 të këtij Ligji, dhe nuk mund të jetë më i gjatë se një (1) vit nga data e marrjes së vendimit.
2. Kur aplikimi është paraqitur pas njoftimit nga Dogana e Kosovës mbi pezullimin e lirit apo ndalimit të mallrave në pajtim me paragrafin 3 të nenit 18 të këtij Ligji dhe nuk përmban informatat e parapara në nën paragrafët 1.6, 1.7 dhe 1.8 të nenit 6 të këtij Ligji, aplikimi aprovohet vetëm për pezullimin e lirit apo ndalimit të atyre mallrave, përveç nëse informatat sigurohen brenda dhjetë (10) ditëve pune pas njoftimit për pezullimin e lirit apo ndalimin e mallrave.
3. Kur pushon vlefshmëria e një të drejtetë pronësisë intelektuale ose kur aplikuesi për arsye të tjera nuk ka më të drejtë të paraqesë aplikim, Dogana e Kosovës nuk ndërmerr asnjë veprim. Vendimi për aprovimin e aplikimit revokohet apo ndryshohet nga Dogana e Kosovës.

Neni 12

Vazhdimi i afatit për veprim doganor

1. Me përfundimin e afatit gjatë të cilit Dogana e Kosovës duhet të ndërmarr veprime, Dogana e Kosovës mund të zgjatë afatin për veprim, pas kërkesës nga bartësi i vendimit dhe, me kusht që bartësi i vendimit të ketë shlyer çdo lloj detyrimi ndaj Doganës së Kosovës sipas vendimit paraprak.
2. Nëse kërkesa për vazhdim të veprimit doganor është pranuar nga Dogana e Kosovës në afat më pak se tridhjetë (30) ditë të punës para se të mbarojë afati që duhet të zgjatet, ajo mund të refuzohet.
3. Dogana e Kosovës njofton bartësin e vendimit për vazhdimin e afatit, brenda tridhjetë (30) ditëve pune nga data e pranimit të aplikimit dhe përcakton periudhën gjatë së cilës Dogana e Kosovës duhet të veprojë.
4. Afati i vazhduar gjatë së cilit Dogana e Kosovës duhet të veprojë fillon nga dita pasuese e datës kur mbaron afati i periudhës së mëparshme dhe ky afat nuk mund të jetë më i gjatë se një (1) vit.
5. Kur pushon vlefshmëria e një të drejte të pronësisë intelektuale ose kur aplikuesi për arsye të tjera nuk ka më të drejtë të paraqesë aplikim, Dogana e Kosovës nuk ndërmerr asnjë veprim. Vendimi për aprovimin e aplikimit revokohet apo ndryshohet nga Dogana e Kosovës.

6. Bartësi i vendimit nuk ngarkohet me pagesë për të mbuluar shpenzimet administrative që dalin nga shqyrtimi i aplikimit për zgjatje të afatit.

7. Formulari për vazhdim të afatit për veprim doganor përcaktohet nga Dogana e Kosovës me akt nënligjor.

Neni 13

Ndryshimi i vendimit në lidhje me të drejtat e pronësisë intelektuale

1. Me kërkesë të bartësit të vendimit, Dogana e Kosovës mund të ndryshojë listën e të drejtave të pronësisë intelektuale të aprovuara me atë vendim.

2. Kur listës i shtohet një e drejtë e re e pronësisë intelektuale, kërkesa duhet të përmbajë informatat që referohen në nën paragrafët 1.3, 1.5, 1.6, 1.7 dhe 1.8 të nenit 6 të këtij Ligji.

Neni 14

Obligimet për njoftim nga Dogana e Kosovës

1. Zyra përgjegjëse e Doganës së Kosovës pranë së cilës është dorëzuar aplikimi, përcjell vendimet në vijim tek zyrat doganore, menjëherë pas aprovimit të tyre:

1.1.vendimet për aprovimin e aplikimit;

1.2.vendimet me të cilat revokon vendimet e aprovimit të aplikimit;

1.3. vendimet për ndryshimin e vendimeve për aprovimin e aplikimit;

1.4. vendimet për vazhdimin e periudhës gjatë së cilës Dogana e Kosovës duhet të veprojë;dhe

1.5. vendimet për pezullimin e veprimeve doganore sipas paragrafit 2 të nenit 16 të këtij Ligji.

Neni 15

Obligimet për njoftim nga bartësi i vendimit

1. Bartësi i vendimit brenda një (1) dite pune njofton Doganën e Kosovës për ndonjë nga rastet e mëposhtme:

1.1. kur një e drejtë e pronësisë intelektuale e mbuluar me aplikacion pushon së pasuri efekt;

1.2. kur bartësit të vendimit i shuhet e drejta të paraqes aplikimin për arsye tjera; dhe

1.3. kur ndryshojnë informatat që përcaktohen në nenin 6 të këtij ligji.

Neni 16

Mos përmbushja e obligimeve nga bartësi i vendimit

1. Kur bartësi i vendimit përdor informatat e siguruar nga Dogana e Kosovës për qëllime tjera nga ato që janë përcaktuar në nenin 21 të këtij ligji, Dogana e Kosovës mund të revokojë vendimin me të cilin është aprovuar aplikimi ndaj bartësit të vendimit dhe të refuzojë vazhdimin e afatit për veprim doganor.

2. Dogana e Kosovës mund të vendos të pezullojë veprimet doganore deri në mbarimin e afatit gjatë së cilit duhet të veprojnë, kur bartësi i vendimit:

2.1. nuk i përmbush obligimet e njoftimit të përcaktuara në nenin 15 të këtij ligji;

2.2. nuk i përmbush obligimet për kthimin e mostrave të përcaktuara në paragrafin 3 të nenin 19 të këtij ligji;

2.3. nuk i përmbush obligimet mbi shpenzimet e përcaktuara në paragrafin 1 dhe 4 të nenit 29 të këtij ligji; dhe

2.4. pa ndonjë arsye të bazuar, nuk inicion procedurat siç përcaktohen në paragrafin 5 të nenit 23 apo të paragrafit 9 të nenin 26 të këtij ligji.

KAPITULLI III

VEPRIMI NGA DOGANA E KOSOVËS

Neni 17

Pezullimi i lirimit apo ndalimit të mallrave pas aprovimit të aplikacionit

1. Kur Dogana e Kosovës identifikon mallrat që dyshohet se shkelin një të drejtë të pronësisë intelektuale, për të cilat është aprovuar vendimi për aplikimin, pezullon lirimin e mallrave apo ndalon këto mallra.

2. Para se të pezullohet lirimi apo ndalimi i mallrave, Dogana e Kosovës mund të kërkojë nga bartësi i vendimit që të sigurojë çfarëdo informate relevante në lidhje me mallrat. Dogana e Kosovës mund të i sigurojë për bartësin e vendimit informata mbi sasinë aktuale apo të përafërt të mallrave, natyrën e tyre aktuale apo të supozuar dhe fotografitë e tyre, sipas nevojës.

3. Dogana e Kosovës njofton deklaruesin apo bartësin e mallrave mbi pezullimin e lirimit apo ndalimin e mallrave brenda një (1) dite pune nga pezullimi apo ndalimi.

4. Kur Dogana e Kosovës vendos të njoftojë bartësin e mallrave/deklaruesin dhe kur dy apo më shumë persona konsiderohen si bartës të tyre, Dogana e Kosovës nuk ka detyrim të njoftojnë më shumë se një nga këta persona.

5. Dogana e Kosovës njofton bartësin e vendimit mbi pezullimin e lirimit apo ndalimin e mallrave në të njëjtën ditë, apo menjëherë pasi të ketë njoftuar deklaruesin apo bartësin e mallrave. Njoftimi përfshin informatat mbi procedurën e përcaktuar në nenin 23 të këtij Ligji.

6. Dogana e Kosovës njofton bartësin e vendimit dhe deklaruesin apo bartësin e mallrave mbi sasinë dhe natyrën reale apo të përafërt të mallrave, përfshirë edhe fotografitë e tyre sipas nevojës, lirimi i të cilave është pezulluar apo ndaluar. Dogana e Kosovës, me kërkesë të bartësit të vendimit dhe kur është e mundur, njofton atë për emrat dhe adresat e marrësit, dërguesit dhe deklaruesit apo bartësit të mallrave, mbi procedurën doganore dhe origjinën, prejardhjen dhe destinimin e mallrave, lirimi i të cilave është pezulluar apo ndaluar.

Neni 18

Pezullimi i lirit apo ndalimi i mallrave para aprovimit të aplikimit

1. Kur Dogana e Kosovës identifikon mallrat të cilat dyshohet se shkelin nje të drejtë te pronësisë intelektuale, por që nuk përfshihen në vendimin me të cilin është aprovuar aplikimi, mundet të pezullojë lirin e mallrave apo t'i ndalojë ato, përveç në rastin e mallrave që prishen lehtë.

2. Para pezullimit të lirit ose ndalimit të mallrave të dyshuara për shkelje të një të drejte të pronësisë intelektuale, Dogana e Kosovës, pa zbuluar ndonjë informacion tjetër përveç sasisë aktuale ose të parashikuar të mallrave, natyrën e tyre aktuale ose të supozuar dhe fotografitë e tyre, mund të kërkojë nga cilido person që potencialisht ka të drejtë të paraqet aplikacionin në lidhje me shkeljen e pretenduar të të drejtave të pronësisë intelektuale për t'u dhënë atyre ndonjë informacion përkatës.

3. Dogana e Kosovës njofton deklaruesin apo bartësin e mallrave mbi pezullimin e lirit apo ndalimin e mallrave brenda një (1) dite të punës nga data e pezullimit apo ndalimit.

4. Kur Dogana e Kosovës njofton bartësin e mallrave dhe kur dy apo më shumë persona konsiderohen të jenë bartës të mallrave, Dogana e Kosovës nuk është obliguar të njoftojë më shumë se njërin nga këto persona.

5. Dogana e Kosovës njofton personat që kanë të drejtë të paraqesin aplikim, në lidhje me shkeljen e pretenduar të së drejtës së pronësisë intelektuale, mbi pezullimin e lirit apo ndalimin e atyre mallrave të njëjtën ditë, apo menjëherë pasi të kenë njoftuar deklaruesin apo bartësin e mallrave.

6. Dogana e Kosovës mund të konsultohet me autoritetet përgjegjëse publike në mënyrë që të identifikojë personat që kanë të drejtë të paraqesin aplikimin. Njoftimet duhet të përfshijnë informatat mbi procedurën e përcaktuar në nenin 23 të këtij ligji.

7. Dogana e Kosovës duhet të lirojë mallrat apo të përfundojë ndalimin e tyre menjëherë pasi të plotësohen të gjitha kushtet formale doganore në rastet në vijim:

7.1. kur nuk i kanë identifikuar asnjë person që ka të drejtë të paraqes aplikimin në lidhje me shkeljen e pretenduar të së drejtës së pronësisë intelektuale brenda një (1) dite të punës nga pezullimi i lirit apo ndalimi i mallrave; dhe

7.2. kur nuk kanë pranuar një aplikacion në pajtim me paragrafin 2 të nenit 5 të këtij Ligji, apo kur kanë refuzuar një aplikacion të tillë.

8. Kur aprovohet aplikimi, Dogana e Kosovës, sipas kërkesës dhe kur është e mundur, njofton bartësin e vendimit për emrat dhe adresat e marrësit të ngarkesës, dërguesin dhe deklaruesin apo bartësin e mallrave, për procedurat doganore dhe origjinën, prejardhjen dhe destinacionin e mallrave, për të cilat është pezulluar lirit apo që janë ndaluar.

Neni 19

Kontrollimi dhe marrja e mostrave të mallrave lirimi i të cilave është pezulluar apo ndaluar

1. Dogana e Kosovës i siguron bartësit të vendimit dhe deklaruesit apo bartësit të mallrave mundësinë për të kontrolluar mallrat, lirimi i të cilave është pezulluar apo ndaluar.

2. Dogana e Kosovës mund të marr mostra të cilat përfaqësojnë mallrat. Me kërkesën e bartësit të vendimit, Dogana e Kosovës mund t'ia ofrojë dhe dorëzojë mostrat bartësit të vendimit vetëm për qëllim të analizave dhe lehtësimit të procedurave në lidhje me mallrat e falsifikuara apo pirate. Çdo analizë e këtyre mostrave kryhet vetëm nën përgjegjësinë dhe me shpenzimet e bartësit të vendimit.

3. Pas përfundimit të analizave, bartësi i vendimit i kthen Doganës së Kosovës mostrat e marra sipas paragrafit 2 të këtij neni, përveç nëse rrethanat nuk e lejojnë ndryshe. Mostrat duhet të kthehen para lirimimit të mallrave apo para përfundimit të ndalimit të tyre.

Neni 20

Kushtet për magazinim

Kushtet për magazinimin e mallrave gjatë periudhës së pezullimit të lirimimit apo ndalimit të tyre përcaktohen nga Dogana e Kosovës në përputhje me legjislacionin doganor në fuqi.

Neni 21

Përdorimi i lejuar i informatave të caktuara nga bartësi i vendimit

1. Kur bartësi i vendimit pranon informatat e parapara në paragrafin 6 të nenit 17, në paragrafin 5 të nenit 18, në nenin 19 apo në paragrafin 8 të nenit 26 të këtij Ligji, ai mund të zbulojë apo shfrytëzojë ato informata vetëm për qëllimet në vijim:

1.1. për të filluar procedurën gjyqësore, që përcakton nëse një e drejtë e pronësisë intelektuale është shkelur, si dhe gjatë kohëzgjatjes së kësaj procedure;

1.2. në lidhje me hetimet penale për shkeljen një të drejte të pronësisë intelektuale të ndërmarrë nga autoritetet kompetente të Republikës së Kosovës;

1.3. për fillimin e procedurës penale dhe gjatë kësaj procedure;

1.4. për të kërkuar kompensim nga shkelësi apo personat tjerë;

1.5. për të rënë dakord me deklaruesin apo bartësin e mallrave që mallrat të shkatërrohen në pajtim me paragrafin 1 të nenit 23 të këtij Ligji; dhe

1.6. për të rënë dakord me deklaruesin apo bartësin e mallrave mbi shumën e garancionit bankar të paraparë në nenin paragrafin 2.1 të nenit 24 të këtij Ligji.

Neni 22**Shkëmbimi i informatave dhe të dhënave ndërmjet autoriteteve doganore**

1. Pa rënë ndesh me dispozitat ligjore në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale në Republikën e Kosovës dhe me qëllim të dhënies së kontributit për shmangien e tregtisë ndërkombëtare të mallrave që shkelin të drejtat e pronësisë intelektuale, Dogana e Kosovës mund të shkëmbejë informatat dhe të dhënat që disponojnë me autoritetet relevante në vendet tjera sipas marrëveshjeve të bashkëpunimit.

2. Informatat dhe të dhënat e referuara në paragrafin 1 të këtij neni, shkëmbehen për të lejuar zbatimin efikas të legjislacionit përkatës për dërgesat e mallrave që shkelin të drejtat e pronësisë intelektuale. Informatat dhe të dhënat e tilla mund të ndërlidhen me konfiskimet, tendencat dhe informatat e përgjithshme për riskun, duke përfshirë edhe mallrat që janë në transit në territorin doganor të Republikës së Kosovës dhe që kanë origjinën nga/apo destinacion një vend tjetërjashtë territorit doganor të Republikës së Kosovës. Në këto të dhëna mund të përfshihen, kur është e nevojshme, informata për:

2.1. natyrën dhe sasinë e mallrave;

2.2. të drejtën e pronësisë intelektuale që dyshohet se është shkelur;

2.3. origjinën, prejardhjen dhe destinacionin e mallrave;

2.4. informatat mbi lëvizjet e mjeteve të transportit, në veçanti:

2.4.1. regjistrimi i mjeteve të transportit;

2.4.2. numrat e referencës së faturës së ngarkesës apo ndonjë dokumenti tjetër të transportit;

2.4.3. numrin e kontejnerëve;

2.4.4. pesha e ngarkesës;

2.4.5. përshkrimi dhe/apo kodimi i mallrave;

2.4.6. numri i rezervimit;

2.4.7. numri i plombës;

2.4.8. vendi i ngarkimit të parë;

2.4.9. vendi i shkarkimit të fundit;

2.4.10. vendet e transbordimit;

2.4.11. data e parashikuar e mbërritjes në vendin e shkarkimit të fundit;

2.5. informata mbi lëvizjen e kontejnerëve, në veçanti:

2.5.1. numri i kontejnerit;

2.5.2. statusi i ngarkesës së kontejnerit;

2.5.3. data a lëvizjes;

2.5.4. lloji i lëvizjes (ngarkim, shkarkim, transferim, hyrje, dalje dhe të ngjashme);

2.5.5. regjistrimi i mjeteve të transportit;

2.5.6. numri i udhëtimeve;

2.5.7. vendi;

2.5.8. fatura e ngarkesës apo dokumentet tjera të transportit.

Neni 23

Shkatërrimi i mallrave dhe fillimi i procedurave

1. Mallrat që dyshohet se shkelin një të drejtë të pronësisë intelektuale mund të shkatërrohen nën mbikëqyrje doganore, pa qenë e nevojshme të vërtetohet nëse është shkelur e drejta e pronësisë intelektuale, kur plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme:

1.1. brenda dhjetë (10) ditëve pune apo tri (3) ditëve pune në rastet e mallrave që prishen lehtë nga data e njoftimit për pezullimin e lirimit apo ndalimin e mallrave, bartësi i vendimit njofton me shkrim Doganën e Kosovës se sipas bindjes së tij është shkelur një e drejtë e pronësisë intelektuale.

1.2. brenda dhjetë (10) ditëve pune apo tri (3) ditëve pune në rastet e mallrave që prishen lehtë nga data e njoftimit për pezullimin e lirimit apo ndalimin e mallrave, bartësi i vendimit njofton me shkrim Doganën e Kosovës për pëlqimin e tij për shkatërrimin e mallrave; dhe

1.3. brenda dhjetë (10) ditëve pune apo tri (3) ditëve pune në rastet e mallrave që prishen lehtë, nga data e njoftimit për pezullimin e lirimit apo ndalimin e mallrave, deklaruesi apo bartësi i mallrave njofton me shkrim Doganën e Kosovës për pëlqimin e tij për shkatërrimin e mallrave. Kur deklaruesi apo bartësi i mallrave nuk ka dhënë pëlqimin e tij për shkatërrimin e mallrave dhe nuk ka paraqitur kundërshtimin e tij me shkrim brenda afatit të paraparë në këtë paragraf, Dogana e Kosovës mund të vlerësojë se deklaruesi apo bartësi i mallrave ka dhënë pëlqimin në heshtje për shkatërrimin e mallrave.

2. Kur Dogana e Kosovës e vlerëson, kërkon nga bartësi i vendimit që të arsyetoj vendimin për shkelje të të drejtave të pronësisë intelektuale të paraqitur sipas nën paragrafit 1.1 të këtij neni, duke i dhënë specifikat e shkeljes

3. Dogana e Kosovës liron mallrat apo përfundon ndalimin e tyre menjëherë pas përfundimit të të gjitha procedurave doganore, kur brenda afateve të përcaktuara në nën paragrafin 1.1 dhe 1.2 të këtij neni, nuk ka pranuar të dy konfirmimet me shkrim nga bartësi i vendimit, atë për pretendim të shkeljes të së drejtës së pronësisë intelektuale dhe pëlqimin e tij për shkatërrimin e mallrave. Përkrahimisht, kur Dogana e Kosovës është informuar për fillimin e procedurës gjyqësore, nëpërmjet paraqitjes së një kopje të padisë dorëzuar në gjykatën kompetente për të vendosur nëse është shkelur e drejta e pronësisë intelektuale, mallrat nuk lirohen dhe nuk përfundon ndalimideri sa gjykata të sjell vendimin në lidhje me këto mallra.

4. Shkatërrimi i mallrave kryhet nën mbikëqyrjen doganore dhe nën përgjegjësinë e bartësit të vendimit. Dogana e Kosovës mund të merr mostra përpara shkatërrimit të mallit, të cilat mund të përdoren për qëllime edukative.

5. Kur deklaruesi apo mbajtësi i mallrave nuk ka dhënë me shkrim pëlqimin e tij për shkatërrimin e mallrave dhe kur Dogana e Kosovës nuk vlerëson se ai ka dhënë pëlqimin e tij në heshtje për shkatërrimin, brenda afatit të përcaktuar në nën paragrafin 1.3 të këtij neni, Dogana e Kosovës e njofton bartësin e vendimit brenda një (1) dite të punës. Në këtë rast, brenda dhjetë (10) ditëve pune apo tri (3) ditëve pune në rastin e mallrave që prishen lehtë, nga njoftimi për pezullimin e lirimimit apo ndalimit të mallrave, bartësi i vendimit duhet të fillojë procedurat gjyqësore për të vërtetuar nëse është shkelur e drejta e pronësisë intelektuale.

6. Përveç në rastin e mallrave që prishen lehtë, Dogana e Kosovës mund të zgjas periudhën e paraparë në paragrafin 5 të këtij neni deri në dhjetë (10) ditë pune, pas një kërkesë të arsyetuar nga bartësi i vendimit në rastet e duhura.

7. Dogana e Kosovës liron mallrat apo përfundon ndalimin e tyre menjëherë pas përfundimit të të gjitha procedurave doganore, kur brenda afateve të përcaktuara në paragrafin 5 dhe 6 të këtij neni, ata nuk janë informuar për fillimin e procedurës gjyqësore, nëpërmjet paraqitjes së një kopje të padisë dorëzuar në gjykatën kompetente për të vlerësuar nëse është shkelur e drejta e pronësisë intelektuale.

8. Afati dhe procedura për shkatërrimin e mallrave rregullohen nga Dogana e Kosovës me akt nënligjor.

Neni 24

Lirimi i mëhershëm i mallrave

1. Kur Dogana e Kosovës është njoftuar për fillimin e procedurës gjyqësore për të përcaktuar nëse një dizajn industrial, patentë, model përdorimi, topografi e një produkti gjysmëpërçues apo varieteti bimor është shkelur, deklaruesi apo mbajtësi i mallrave mund të kërkojë nga Dogana e Kosovës lirimimin e mallrave përpara përfundimit të procedurave.

2. Dogana e Kosovës liron mallrat apo përfundon ndalimin e tyre vetëm kur plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme:

2.1. Deklaruesi apo mbajtësi i mallrave depoziton garancion bankar në vlerën e mjaftueshme për të mbrojtur interesat e bartësit të vendimit;

2.2. Gjykata kompetente që përcakton nëse është shkelur një e drejtë e pronësisë intelektuale, nuk ka dhënë një masë për sigurim të kërkesë padisë për mallrat; dhe

2.3. Kur janë kryer të gjitha procedurat doganore.

3. Depozitimi i garancionit bankar të paraparë në nën paragrafin 2.1 të këtij neni, nuk cenon mjetet tjera juridike në dispozicion të bartësit të vendimit.

Neni 25 **Mallrat për shkatërrim**

1. Mallrat që duhet të shkatërrohen sipas nenit 23 apo nenit 26 të këtij Ligji nuk duhet të:

- 1.1. lirohen për qarkullim të lirë;
- 1.2. largohen nga territori doganor i Republikës së Kosovës;
- 1.3. eksportohen;
- 1.4. ri-eksportohen;
- 1.5. vendosen nën një procedurë pezulluese;
- 1.6. vendosen në zonë apo depo të lirë.

2. Përjashtimisht nga paragrafi 1 i këtij neni, kur Dogana e Kosovës me marrëveshje me bartësin e vendimit, vendos që në raste të caktuara mallrat duhet të riciklohen apo të hidhen jashtë kanaleve komerciale, përfshirë ngritjen e vetëdijesimit për qëllime trajnuese dhe edukative, këto mallra lirohen për qarkullim të lirë. Kushtet nën të cilat mallrat mund të lirohen për qarkullim të lirë përcaktohen me akt nënligjor nga Dogana e Kosovës.

3. Dogana e Kosovës mund të lejojë që mallrat e përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni të lëvizin nën mbikëqyrjen doganore brenda territorit doganor të Republikës së Kosovës, me qëllim shkatërrimin të tyre nën mbikëqyrjen doganor.

Neni 26 **Procedura për shkatërrimin e mallrave në dërgesa të vogla**

1. Mallrat në dërgesa të vogla mund të shkatërrohen nëse përmbushin të gjitha kushtet e mëposhtme:

- 1.1. dyshohet se mallrat janë të falsifikuara apo pirate;
- 1.2. janë mallra që nuk prishen lehtë;
- 1.3. mallrat mbulohen me vendimin e aprovuar të aplikimit;
- 1.4. bartësi i vendimit ka kërkuar në aplikim përdorimin e procedurës së përcaktuar në këtë nen; dhe

- 1.5. mallrat janë transportuar në dërgesa të vogla.
2. Kur zbatohet procedura e përcaktuar në këtë nen, paragrafët 3, 4, 5 dhe 6 të nenit 17, si dhe paragrafët 2 dhe 3 të nenit 19 të këtij Ligji nuk zbatohen.
3. Dogana e Kosovës njofton deklaruesin apo mbajtësin e mallrave për pezullimin e lirimit të mallrave apo ndalimin e tyre brenda një (1) dite pune nga data e pezullimit të lirimit apo ndalimit të mallrave. Në njoftimin e pezullimit të lirimit apo ndalimit të mallrave përfshihen:
 - 3.1. njoftimin se Dogana e Kosovës ka për qëllim të shkatërrojë mallrat; dhe
 - 3.2. të drejtat e deklaruesit apo bartësit të mallrave sipas paragrafëve 4, 5 dhe 6 të këtij neni.
4. Deklaruesit apo mbajtësit të mallrave i ofrohet mundësia për të shprehur mendimin e tij brenda dhjetë (10) ditëve pune pas njoftimit për pezullimin të lirimit apo ndalimit të mallrave.
5. Mallrat mund të shkatërrohen kur brenda dhjetë (10) ditëve pune nga data e njoftimit të pezullimit të lirimit të mallrave apo ndalimit të tyre, deklaruesi apo mbajtësi i mallrave ka dhënë pëlqimin e tij për shkatërrimin e mallrave, pranë Doganës së Kosovës.
6. Kur deklaruesi apo mbajtësi i mallrave nuk ka dhënë pëlqimin e tij për shkatërrimin e mallrave dhe nuk ka njoftuar kundërshtimin e tij pranë Doganës së Kosovës, brenda afatit të parapare në paragrafin 5 të këtij neni, Dogana e Kosovës mund të vlerësojnë se deklaruesi apo mbajtësi i mallrave ka dhënë pëlqimin e tij për shkatërrimin e mallrave.
7. Shkatërrimi kryhet nën mbikëqyrje doganore. Dogana e Kosovës, sipas kërkesës dhe kur është e mundur, i vë në dispozicion bartësit të vendimit informata për sasinë reale apo të vlerësuar të mallrave të shkatërruara dhe natyrën e tyre.
8. Kur deklaruesi apo mbajtësi i mallrave nuk ka dhënë me shkrim pëlqimin e tij dhe kur nuk vlerësohet se ka dhënë pëlqimin e tij për shkatërrimin e mallrave në përputhje me paragrafin 6 të këtij neni, Dogana e Kosovës njofton menjëherë bartësin e vendimit për këtë dhe për sasinë dhe natyrën e mallrave. Dogana e Kosovës, sipas kërkesës, e njofton bartësin e vendimit me emrat dhe adresën e pranuesit të mallit, të dërguesit dhe deklaruesit apo mbajtësit të mallrave, procedurën doganore dhe origjinën, prejardhjen dhe destinacionin e mallrave, lirimi i të cilave është pezulluar apo ndaluar.
9. Dogana e Kosovës liron mallrat apo përfundon ndalimin e tyre menjëherë pas përfundimit të të gjitha procedurave doganore, kur nuk kanë marrë informata nga bartësi i vendimit për fillimin e procedurës gjyqësore, nëpërmjet paraqitjes së një kopje të padisë dorëzuar në gjykatën kompetente për të vlerësuar nëse është shkelur e drejta e pronësisë intelektuale, brenda dhjetë (10) ditëve pune nga data e njoftimit të paraparë në paragrafin 8 të këtij neni.

KAPITULLI IV PERGJEGJESIA DHE SHPENZIMET

Neni 27

Përgjegjësia e Doganës së Kosovës

1. Vendimi për aprovimin e aplikimit nuk i jep të drejtë bartësit të vendimit për të kërkuar kompensim nëse mallrat që dyshohen se shkelin të drejtën e pronësisë intelektuale nuk janë zbuluar nga Dogana e Kosovës dhe, si rrjedhojë, janë liruar apo nuk është kryer asnjë veprim për ndalimin e tyre.

2. Përbushja e kompetencave dhe veprimeve të ndërmarra nga Dogana e Kosovës në pajtim me këtë ligj nuk do ta bëjnë atë përgjegjës për kompensim ndaj personave të përfshirë në situatat që referohen në paragrafin 1 të nenit 2, apo të personave që referohen në nenin 18 të këtij ligji.

Neni 28

Përgjegjësia e bartësit të vendimit

1. Në përputhje me legjislacioni në fuqi, bartësi i vendimit është përgjegjës kundrejt çdo mbajtësi të mallrave apo deklaruesit, i cili ka pësuar dëm nga situatat e mëposhtme:

1.1. kur procedura gjyqësore e filluar sipas këtij Ligji ndërpritet apo pushohet për shkak të një veprimi apo mosveprimi nga bartësi i vendimit;

1.2. kur mostrat e marra sipas paragrafit 2 të nenit 19 të këtij Ligji nuk kthehen apo janë dëmtuar dhe janë jashtë përdorimit për shkak të një veprimi apo mosveprimi nga bartësi i vendimit; apo

1.3. kur vërtetohet se mallrat nuk shkelin një të drejtë të pronësisë intelektuale.

2. Nëse bartësi i vendimit dështon të veprojë në pajtim me paragrafin 1 të nenit 23 të këtij ligji, Dogana e Kosovës mund të vendos të mos veprojë sipas vendimit për aprovimin e aplikacionit. Në këtë rast bartësi i vendimit humb të drejtën për të dorëzuar një aplikacion të ri mbi të drejtën e njëjtë të pronësisë intelektuale brenda një (1) viti.

Neni 29

Shpenzimet

1. Kur kërkohet nga Dogana e Kosovës, bartësi i vendimit kompenzon shpenzimet shkaktuara nga Dogana e Kosovës apo nga palët e tjera që veprojnë në emër të Doganës së Kosovës, nga momenti i pezullimit të lirimit të mallrave apo ndalimit të tyre, përfshirë magazinimin dhe trajtimin e mallrave, në përputhje me paragrafin 1 të nenit 17, me paragrafin 1 të nenit 18, dhe me paragrafët 2 dhe 3 të nenit 19, dhe kur përdoren masa korigjuese, siç është shkatërrimi i mallrave, në përputhje me nenet 23 dhe 26 të këtij Ligji.

2. Bartësi i vendimit, të cilit i është njoftuar pezullimi i lirimit të mallrave apo ndalimi i tyre, në bazë të kërkesës së tij, informohet nga Dogana e Kosovës për vendin dhe mënyrën e magazinimit të këtyre mallrave dhe për shpenzimet e vlerësuara të magazinimit, e paraparë në paragrafin 1 të këtij neni. Informatat për shpenzimet e vlerësuara mund të shprehen në terma të kohës,

produktit, volumit, peshës ose shërbimit në varësi të rrethanave të magazinimit dhe natyrës së mallrave.

3. Ky nen nuk cenon të drejtën e bartësit të vendimit për të kërkuar kompensim nga shkelësi apo personat e tjerë në përputhje me legjislacionin në fuqi.

4. Bartësi i vendimit paguan çdo përkthim që kërkohet nga Dogana e Kosovës në lidhje me mallrat që dyshohet se shkelin të drejtat e pronësisë intelektuale.

KAPITULLI V

SHKËMBIMI I INFORMATAVE DHE TË DHËNAVE MBI APLIKACIONET PËR VEPRIME DOGANORE

Neni 30

Krijimi i bazës elektronike së të dhënave

Për qëllime të shkëmbimit të informatave që referohen në paragrafin 1 të neni 6, dhe neni 14 të këtij ligji, Dogana e Kosovës krijon dhe administron bazë qendrore të të dhënave.

Neni 31

Mbrojtja e të dhënave

1. Përpunimi i të dhënave personale nga Dogana e Kosovës kryhet në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave në Republikën e Kosovës.

2. Të dhënat personale merren dhe përdoren vetëm për qëllimet e këtij Ligji, dhe ato duhet të jenë të sakta dhe të përditësuara.

3. Dogana e Kosovës përfshin të dhëna personale në bazën e të dhënave dhe kontrollon përpunimin e këtyre të dhënave.

4. Subjekti i të dhënave ka të drejtën e qasjes në të dhënat personale të tij, të cilat përpunohen nëpërmjet bazës së të dhënave. Nëse është e nevojshme, subjekti i të dhënave ka të drejtë të ndryshojë, të fshijë apo të ndalojë të dhënat personale, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e dhënave personale.

5. Kërkesat për ushtrimin e të drejtave të qasjes, ndryshimit, fshirjes apo ndalimit të të dhënave duhet të paraqiten pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Dogana e Kosovës, e cila është organi kompetent që i shqyrton ato.

6. Të dhënat personale nuk ruhen për më shumë se gjashtë (6) muaj nga data e revokimit të vendimit që miraton aplikimin apo nga data e përfundimit të afatit, gjatë të cilit Dogana e Kosovës kryen veprimet për mbrojtjen e një të drejte të pronësisë intelektuale.

7. Kur bartësi i vendimit ka filluar një procedim gjyqësor, në përputhje me paragrafin 5 të neni 23 dhe paragrafit 9 të neni 26 të këtij Ligji, dhe ka njoftuar Doganën e Kosovës për fillimin e procedurës, të dhënat personale ruhen gjashtë (6) muaj pas vendimit gjyqësor të formës së prerë, që përcakton nëse ka pasur shkelje të një të drejte të pronësisë intelektuale.

KAPITULLI VI DISPOZITAT NDËSHKUESE

Neni 32 Dispozitat kundërvajtëse

1. Çdo person i cili vepron në kundërshtim me nenin 15 të këtij ligji, i shqiptohet gjobë si në vijim:

1.1. Për personat juridik, shqiptohet gjobë nga pesëqind (500) euro deri në pesëmijë (5,000) euro;

1.2. Për personat fizik, shqiptohet gjobë prej dyqind e pesëdhjetë (250) euro deri në dymijë e pesëqind (2,500) euro;

1.3. Për personat e autorizuar të personave juridik, shqiptohet gjobë prej njëqind (100) euro deri në pesëqind (500) euro;

1.4. Për personat tjerë, shqiptohet gjobë nga një mijë (1,000) euro deri në dhjetëmijë (10,000) euro.

2. Çdo person i cili vepron në kundërshtim me nenin 21 të këtij ligji dhe/apo shfrytëzon informatat e dhëna nga Dogana e Kosovës në kundërshtim me këtë nen, me paragrafin 6 të nenit 17, paragrafin 8 të nenit 18, nenin 19 dhe/apo me paragrafin 8 të nenit 26, i shqiptohet gjobë si në vijim:

2.1. Për personit fizik dhe personat të autorizuar i shqiptohet gjobë nga pesëqind (500) euro deri në pesëmijë (5,000) euro; dhe

2.2. Për personat juridik dhe personat tjerë, shqiptohet gjobë nga njëmijë (1,000) euro deri në dhjetëmijë (10,000) euro;

3. Çdo person i cili fut apo nxjerr, apo tenton futjen apo nxjerrjen e mallrave që shkelin të drejtën e pronësisë intelektuale nga territori doganor i Republikës së Kosovës, të cilit një herë i janë konfiskuar dhe shkatërruar mallrat, apo kur ato mallra janë vendosur apo është tentuar të vendosen nën procedurën doganore me ndikim ekonomik apo të futen apo nxirren nga një zonë ose depo e lirë sipas dispozitave ligjore në fuqi, i shqiptohet gjobë si në vijim:

3.1. Për personit fizik, personit të autorizuar apo deklaruesit i shqiptohet gjobë nga pesëqind (500) euro deri në pesëmijë (5,000) euro; dhe

3.2. Për personat juridik dhe personat tjerë, shqiptohet gjobë nga njëmijë (1,000) euro deri në dhjetëmijë (10,000) euro;

4. Përjashtimisht nga paragrafi 2 dhe 3 i këtij neni, nëse vlera e mallrave që i nënshtrohen kundërvajtjes nuk kalon vlerën prej pesëqind (500 €) euro, personit fizik i shqiptohet gjobë në shumë prej pesëdhjetë (50 €) dhe personit juridik i shqiptohet gjobë në vlerë prej dyqind (200) euro, me kusht që kryesi i kundërvajtjes të paguaj gjobën e shqiptuar brenda një (1) dite pune.

5. Nëse kryesi i kundërvajtjes refuzon ta paguaj gjobën sipas paragrafit 4 të këtij neni, kundër

tij fillon procedura e rregullt e kundërvajtjes, siç parashihet në Kodin Doganor dhe të Akcizave dhe legjislacionin tjetër në fuqi.

KAPITULLI VII DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 33 Shfuqizimi

Ky ligj shfuqizon Ligjin Nr. 03/L-170 mbi Masat Doganore për Mbrojtjen e të Drejtave të Pronësisë Intellektuale.

Neni 34 Dispozitat kalimtare

Vendimet e dhëna në pajtim me Ligjin Nr.03/L-170 mbi Masat Doganore për Mbrojtjen e të Drejtave të Pronësisë Intellektuale do të mbesin të vlefshme për atë periudhë që është cekur në aplikacionin e aprovuar. Dogana e Kosovës do të ndërmarr veprime brenda afateve të specifikuara në aplikacionin e pranuar.

Neni 35 Aktet nënligjore

Aktet nën-ligjore për zbatimin e këtij ligji miratohen brenda gjashtë (6) muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 36 Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Ligji Nr. 06/L -015
30 mars 2018**

Shpallur me dekretin Nr. DL-014-2018, datë 20.04.2018 nga Presidenti i Republikës së Kosovës Hashim Thaçi